Trajtimi i Ujërave të Zeza në Ferizaj

Shteti:	KOSOVË
Projekti Nr.:	54538
Sektori i biznesit:	Infra. komunale dhe mjedisore
Lloji i Njoftimit:	Sektori Shtetëror
Kategoria Mjedisore:	B
Data e Synuar e Aprovimit:	14 dhjetor 2023
Statusi:	Në pritje të aprovimit
DPP i shpalosur:	27 shtator 2023

Përshkrimi i projektit

Sigurimi i një kredije sovrane deri në 20 milionë euro për Republikën e Kosovës në dobi të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit Bifurkacioni ("KRU Bifurkacioni" ose "Kompania") për financimin e zgjerimit të rrjetit të grumbullimit të ujërave të zeza dhe ndërtimin e një impianti të ri për trajtim të ujërave të zeza ("ITUZ") në zonën jugore ujëmbledhëse të qytetit të Ferizajt dhe komuniteteve fqinje ("Projekti"). Kredja do të adresojë nevojat kritike për trajtimin e ujërave të zeza në Ferizaj dhe do të jetë në dobi të rreth 90,000 banorëve.

Objektivat e Projektit

Financimi do t'i mundësojë Kompanisë të zgjerojë rrjetin e vet të ujërave të zeza dhe të ndërtojë një ITUZ të ri në mënyrë që t'i mbledhë dhe trajtojë ujërat e zeza në përputhje me standardet relevante mjedisore të BE-së. Zbatimi i Projektit do të rezultojë në përfitime të rëndësishme mjedisore duke reduktuar ndjeshëm vëllimet e ujërave të zeza të papërpunuara dhe ngarkesat ndotëse të lidhura me to, që do të shkarkohen direkt në lumë dhe në burimet lokale të ujërave të ëmbla.

Ndikimi në Tranzicion

ETI 63

Ndikimi ne tranzicion i Projektit do të rrjedhë nga cilësitë e mëposhtme të tranzicionit:
1) *I gjelbër*. Projekti pritet të arrijë pajtueshmëri me standardet mjedisore të BE-së për trajtimin e ujërave të zeza. Projekti mbështet plotësisht qasjen e Bankës për Tranzicionin drejt Ekonomisë së Gjelbër duke financuar një infrastrukturë kyçe që është vendimtare për mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit.

2) *I qeverisur mirë*. Banka do të mobilizojë asistencën teknike për të përmirësuar Kontratën e Shërbimit Publik ("KSHP") ndërmjet Kompanisë dhe komunave të cilave u shërben. Projekti gjithashtu do të mbështesë përmirësimet e qeverisjes së korporatës nëpërmjet Programit për Përmirësimin e Performancës Financiare dhe Operative ("FOPIP").

Informata për Klientin

Republika e Kosovës

Përfituesi i Projektit është KRU Bifurkacioni, një shoqëri aksionare, plotësisht në pronësi të shtetit. Kompania menaxhon dhe operon me ujësjellësin dhe ujërat e zeza në tre komuna (Ferizaj, Kaçanik dhe Han i Elezit) duke u shërbyer përafërsisht 33,000 amvisërive dhe konsumatorëve komercialë dhe institucionalë, duke mbuluar një zonë shërbimi me një popullatë prej rreth 124,000 banorësh.

Përmbledhja e Financimit të BERZH-it

20,000,000,00 EURO

Kredi sovrane për Republikën e Kosovës në dobi të KRU Bifurkacioni.

Gjithsej Kosto të Projektit

30,000,000,00 EURO

Përmbledhja Mjedisore dhe Sociale

Kategoria B (2019 PMS). Kujdesi i duhur mjedisor dhe social ("MS") ("KDMS") është zhvilluar nga një konsulent i pavarur, duke përfshirë një auditim të kompanisë dhe vlerësimin e risqeve dhe ndikimeve MS të projektit në përputhje me Politikat për MS dhe Kërkesat e Performancës ("KP") të BERZH-it.

Gjetjet e KDMS-së kanë treguar se Kompania ka një grup të procedurave për MS për zbutjen e risqeve të MS gjatë zbatimit dhe funksionimit të Projektit, të cilat janë zhvilluar si pjesë e certifikimit të jashtëm për sistemet e menaxhimit ISO 9001, ISO 14001, ISO 17025 dhe ISO 18001. KDMS-ja ka identifikuar disa fusha për përmirësim për ta strukturuar Projektin që të përafrohet me KP-të e Bankës të vitit 2019 dhe praktikat e mira ndërkombëtare, të cilat janë përfshirë në një Plan Veprimi Mjedisor dhe Social ("PVMS") të dakorduar.

Do të duhet të respektohen procedurat kombëtare të lejeve dhe të merren një sërë lejesh. Procedurat e menaxhimit të kontraktorit specifik për projektin për periudhën e ndërtimit do të jenë pjesë e Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social të Ndërtimit ("PMMSN") që do të zhvillohen nga njësia e zbatimit të projektit ("NJZP") dhe implementohen nga kontraktori ndërtues nën monitorimin e NJZP-së dhe palës së tretë të mbikëqyrjes së jashtme. Në përputhje me PVMS-në, kontraktori poashtu do të duhet të zhvillojë një Procedurë për Menaxhim të Ndryshimit për finalizimin e dizajnit, për të menaxhuar në mënyrë adekuate çdo ndryshim të dizajnit të kërkuar gjatë ndërtimit ose ndryshime të tjera gjatë ndërtimit. Ndikimet operacionale do të menaxhohen nga NJZP në kuadër të Sistemit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social.

KRU Bifurkacioni është në pajtueshmëri të plotë me Ligjin për Punën në Kosovë, dhe dispozitat dhe procedurat për BNJ të kompanisë janë në përputhje me kërkesat lokale dhe pajtueshmëri me KP 2. Kontraktorët nuk janë përzgjedhur ende dhe kontraktorët do të duhet të zbatojnë një mekanizëm të

brendshëm të ankesave që punëtorët të jenë në pajtueshmëri të plotë me KP 2. Një auditim i jashtëm i punës është poashtu i përfshirë në PVMS për të monitoruar përputhshmërinë me KP 2 për kulmin e ndërtimit.

Projekti do të ofrojë përfitime të konsiderueshme mjedisore dhe shëndetësore duke parandaluar ndotjen nga shkarkimet e ujërave të zeza të patrajtuara në lumin lokal. Rekomandimet specifike për trajtimin e ujërave do të zbatohen në dizajnin e detajuar, duke përfshirë trajtimin e ujërave të zeza sipas standardeve të BE-së, ripërdorimin e llumit dhe efiçiencën e energjisë së impiantit. Si rezultat i procesit të trajtimit të ujërave të zeza, reduktimi i pritur i emetimeve të CO2 është përafërsisht 12,099 ton CO2e/vit. Zgjedhja e tretjes anaerobe të llumit me prodhimin e energjisë elektrike për nevojat e ITUZ (2,442 kWh/ditë dhe mbi 50% të kërkesave për energji) do të kontribuojë në reduktimin e emetimeve të GS-ve. Parandalimi dhe kontrolli i ndotjes, përfshirë kontrollin e erërave, si dhe menaxhimi i risqeve për shëndetin dhe sigurinë, do të sigurohet nëpërmjet masave të PVMS-së për zhvillimin dhe zbatimin e PMMSN-së me nën-planet shoqëruese.

Një Kornizë për Blerjen e Tokave dhe Rimëkëmbjen e Mjeteve të Jetesës është përgaditur dhe shpalosur në përputhje me KP 5, dukë përfshirë masat për mbylljen e boshllëqeve me KP5, angazhimin e grupeve të cenueshme dhe të ndryshme etnike. Projekti dhe objektet e lidhura me të (500 m linjë ajrore, rruga hyrëse dhe zgjerimi i kolektorit kryesor të ujërave të zeza) nuk pritet të përfshijnë zhvendosje fizike. Pritet që 33 parcela të shpronësohen. PVMS-ja përcakton përgatitjen e një Plani për Blerje të Tokave dhe Rimëkëmbje të Mjeteve të Jetesës" ("PBTRMJ") bazuar në Kornizën, i cili do të zhvillohet sapo të bëhet e njohur natyra e saktë dhe fushëveprimi i blerjes së tokës, për të siguruar pajtueshmërinë e plotë me KP5. Ekzekutimi i planit do të monitorohet përmes raportimit të rregullt të NJZP-së dhe nga një auditim përfundimtar i jashtëm i ekzekutimit.

Projekti nuk ndodhet në një zonë të ndjeshme për sa i përket lokacioneve Natura 2000 ose zonave të mbrojtura në nivel lokal. Ekzaminimi për habitatet kritike u ndërmor si pjesë e KDMS-së, duke identifikuar një lloj habitati (E3.4 kullotë me lagështi ose eutrofike dhe mezotrofike) që kishte nevojë për masa të targetuara kompensimi në përputhje me PVMS-në dhe PMMS-në, pasi që i plotësonte kriteret për përcaktimin e tipareve të biodiversitetit prioritar. Nuk priten ndikime në trashëgiminë e njohur kulturore dhe gjetjet e rastësishme do të menaxhohen përmes Procedurës për Gjetje të Rastit, siç përcaktohet nga PVMS-ja.

Kompania e ka kapacitetin për të zbatuar Planin për Angazhim të Palëve të Interesit ("PAPI") të përgatitur për Projektin, si dhe do të zhvillojë një mekanizëm për ankesa për të adresuar ankesat për palët e jashtme të interesit, në përputhje me PVMS-në. Si PAPI ashtu edhe përmbledhja jo-teknike janë shpalosur publikisht në gjuhën angleze dhe në gjuhët lokale.

Banka do të monitorojë zbatimin e Projektit përmes shqyrtimit të raporteve vjetore të monitorimit dhe vizitave në terren sipas nevojës.

Bashkëpunimi Teknik

Detyrat e mëposhtme të Bashkëpunimit Teknik janë parashikuar si pjesë e këtij Projekti (dhe do të finalizohen gjatë procesit të aprovimit):

Para nënshkrimit

- BT1 - Përditësimi i studimit të fizibilitetit, duke përfshirë kujdesin e duhur mjedisor dhe social (i përfunduar).

Pas nënshkrimit

- BT2 - Mbështetje e avancuar prokurimi për t'i ndihmuar Kompanisë me prokurimin e konsulentëve mbështetës dhe mbikëqyrës të njësisë së zbatimit të projektit ("NJZP").

- BT3 - Ndihmë për prokurimin dhe zbatimin për NJZP-në, duke përfshirë prokurimin, mbikëqyrjen dhe administrimin e kontratave.
- BT4 - Programi për Zhvillim të Korporatës, duke përfshirë një FOPIP, rishikim i KSHP-së në përputhje me standardet e BE-së, si dhe zhvillimi i një plani për menaxhimin e aseteve të infrastrukturës.

Vlera e shtuar

Vlera shtesë e Bankës rrjedh nga: i) sigurimi i shumës ë dhe afatit të kredisë që nuk disponohet në treg nga huadhënësit komercialë; ii) mbështetja e Bankës për përditësimin e KSHP-së që do të jetë në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare; dhe iii) mbështetja e Bankës për përmirësimin e kapaciteteve të Kompanisë marrë parasysh përvojën e saj të kufizuar në zbatimin e projekteve në shkallë të gjerë të financuara nga institucionet financiare ndërkombëtare.

Informatat e Kontaktit të Kompanisë

Jeton Shabani
info@bifurkacioni.com
+381 (0) 290 320 650
http://bifurkacioni.com
Enver Topalli, Ferizaj, 70000

Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni këtu.

Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:
Tel: +44 20 7338 7168
Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni Prokurimet e BERZH:

Tel: +44 20 7338 6794
Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH-it.

Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

PMS dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për

promovimin e “zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor”. PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankimimit për të adresuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket përgjegjë sisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t’i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikat e BERZH në këtë aspekt jepet në PMS.

Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t’u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t’u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efikase për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt.
OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime prr praktika mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdolloj gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e Politikës së Qasjes në Informacion për t’u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.
Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH.

Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimimit në nivel projekti të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t’i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH .
MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me Politikën Mjedisore dhe Sociale apo dispozitat specifike për Projektin të Politikës së Qasjes në Informacion; dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe cdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitoni faqen e webit për Mekanizmin e Pavarur për Përgjegjsinë ndaj Projektit për të mësuar më shumë mbi MPPP dhe misionin e tij; si dhe për të dërguar një kërkesë për rishikim; ose për të kontaktuar MPPP përmes emailit ipam@ebrd.com për më shumë informacion dhe udhëzime mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.